

Republika e Turqisë është shprehur e gatshme që ta ndihmojë armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri i Mbrojtjes i Turqisë, Ismet Yilmaz, ka thënë se ky shtet dëshiron që Kosova të jetë shtet funksional, ta këtë ushtrinë dhe policinë e vet dhe në këtë çështje Turqia do ta jap kontributin e vet.

“Nuk duhet të këtë dallime ndërmjet Kosovës dhe shteteve tjera të Ballkanit. Kosova duhet të jetë e barabartë me të gjitha shtetet e Ballkanit, as ma pak e as ma shumë “, ka thënë ministri Turk.

Ai ka premtuar se Turqia do ta mbështesë në vazhdimësi Forcën e Sigurisë së Kosovës në rrugën e saj drejt transformimit në ushtri të rregullt.

I pyetur nëse duhet ndërhyrja ushtarake për shpërbërjen e strukturave ilegale serbe të cilat funksionojnë në territorin e Kosovës, ministri turk është shprehur kundër një ndërhyrje të tillë, duke theksuar se zgjidhja e vetme në këtë drejtim është përmes dialogut.

Ai këto komente i ka bërë pas takimit që ka pasur me homologun e tij Agim Çeku. Ndërsa ministri Çeku duke falënderuar ministrin turk për kontributin e dhënë ka thënë se Turqia është ndër vendet që me se shumtë e ka ndihmuar forcimin e FSK-së.

“Turqia na ka furnizuar FSK-në me disa autoblanda, ndërsa sot morëm premtimin edhe për një ndihmë tjetër, po ashtu me disa autoblanda të cilët do të ndihmojnë në forcimin edhe me të madh të FSK-së. /Lajm/